

Trashegimia E Tudjman Eshte Nje Peshe E Rende Ne Qafen E Kroacise

Author: [Christopher Bennett](#)

Me renien e Presidentit te saj, Kroacia ka nje mundesi te ndahet nga e kaluara dhe te largohet politikisht nga Ballkani per te hyre ne Europen Perendimore. Por trashegimia e Franjo Tudjman do te vazhdoje te rendoje ne te ardhmen e saj...

Gjate tete vjete e gjysem ne pushtet babai i veteshpallur i kombit ka kerkuar dhe, ne nje shkalle te madhe ka arritur ti jape Kroacise fytyren e tij. Ne kete proces, ai e ka ndryshuar reputacionin e vendit te tij nga nje destinacion turistik piktoresk i cili ra viktime e agresionit Serb ne nje vend diktature nacionaliste.

Kur ne vitin 1991 forcat e parregullta Serbe dhe Ushtria Jugosllave rrethuan qytetet Kroate te Vukovar dhe Dubrovnik, duke shkaterruar te parin dhe duke demtuar pasurine kulturore te Dubrovnikut, ishte e pamundur te mos ndjeje keqardhje per kauzen Kroate.

Por pas Marreveshjes se Sarajevos ne Janar te 1992, e cila i dha fund luftes ne Kroaci dhe solli njohjen nderkombetare te republikes, Tudjman tregoi fytyren e tij te vertete. Ai ju kthye kundertshtareve te tij te brendeshem, duke vene nen kontroll median e pavrur dhe duke mbytur cdo kundertshtim ndaj tij. Ai gjithashtu u perpoq te realizonte vizionin e tij per Kroacine e madhe ne dem te Bosnjes.

Kryqezata e Tudjman ne Bosnje rezultoi e pasukseseshme dhe e gabuar, sepse pas disa fitoreve te Kroacise ne fillim te saj, forcat muslimane arriten te ndryshonin drejtimin e gjerave. Reputacioni i Kroacise ne syte e botes filloi te shkaterrohej ndersa dolen ne drite deshmite e krimeve te Kroateve kunder Muslimaneve. Nderkohe, pas nje sere humbjesh ushtarake ne Bosnjen Qendrore, banoret lokal Kroate u larguan ne mase.

Pakenaqesite ne Kroaci me luften e presidentit te tyre ne Bosnje sollen nje largim ne mase te njerezve nga nivele te larta te Bashkimit Demokratik Kroat (HDZ) te udhehequr nga Tudjman, perfshire edhe Stipe Mesic, presidentin e fundit te Jugosllavise.

Ne gjashte vjetet qe pasuan, HDZ largoi edhe shume nga njerezit e saj me te zote dhe te moderuar, perfshire Franjo Greguric ne 1998, nje ish kryeminister dhe i derguar special ne Bosnje.

Pas deshtimit ne arritjen e synimeve te tij ne Bosnje, Tudjman u shpetua nga pasojat e politikës se tij nga diplomacia intensive e SHBA qe i dha fund luftes Kroato-Muslimane ne 1994.

Marreveshja e Washington ne Mars 1994 krijoi nje federate te dobet Boshnjake, e cila mendohej se do te bashkohej ne nje konfederate me Kroacine. Megjithate, praktikisht, ajo cimentoi linjen e frontit Kroato-Musliman dhe Tudjman vazhdoi te sillej sikur territoret e kontrolluara nga Kroatet ne Bosnje ishin pjese e Kroacise.

Me mbarimin e luftes, Kroacia pati mundesi te riarmatosej dhe te forcohej ushtarakisht. Ne sulem te befasishme gjate Majit dhe Gushtit 1995 Ushtria Kroate fitoi pjesen me te madhe te territoreve te cilat kontrolltoheshin nga Serbet e Kroacise qe prej kater vjetesh, dhe rreth 200,000 Serb u larguan sepse kishin frike te jetonin nen sundimin Kroat. Enklava tjetere e mbajtur nga Serbet ne Kroaci u dorezua dy vjet me vone pas nje periudhe tranzitore nen administrimin e OKB.

Fitoret ushtarake dhe marrja e Knin, qendra e revoltës Serbe në Kroaci, në Gusht 1995 ishte momenti i triumfit të Tudjman dhe fillimi i fundit të ideologjisë së tij politike. Në mungesë të kercenimit Serb, nacionalizmi i promovuar nga Tudjman humbi terren në rradhet e Kroateve të thjeshtë, por ai nuk mundi të ndryshojë kursin e tij.

Si shumë politikane të tjera të cilët kanë qendruar në pushtet për shumë kohe, Tudjman u bind se ajo që ishte e mirë për të duhet të ishte e mirë edhe për Kroacinë dhe ngatërroi interesat e tij personale me ato të partise dhe ato kombëtare.

Për më tepër, ai besonte me të vërtetë se kishte misionin historik të krijimit me forca të një shteti të fuqishëm Kroat dhe se kjo kërkonte bashkimin ndërmjet Kroateve të Kroacisë dhe Bosnjës. Në fakt, kjo deklarate e tij e fundit publike e rëndësishme përpara se të shtrohej në spital nënkuptonte krijimin e një entiteti të tretë, atij Kroat në Bosnje.

Nacionalizmi i shfrenuar i Tudjman ishte një tregues i frustracionit të tij gjatë 25 vjetëve të vështirë që kishte kaluar pas largimit nga Partia Komuniste pas vitit 1965.

Tudjman ishte bashkuar me partizanet e Titos kur ishte mjaft i ri, në moshën 23 vjeç ai ishte kolonel, dhe pasi u transferua në shtabin e Ushtrisë Jugosllave në Beograd, ai u bë gjenerali më i ri i vendit në moshën 38 vjeçare. Ai ishte një nder njerezit më të privilegjuar në shoqërinë Komuniste Jugosllave dhe u mesua që në moshë tepër të re të jepte urdhera dhe të bindeshin.

Shkrimet e hershme historike të Tudjman – të cilat përfshijnë edhe historitë e regjimentit të tij në kohën e luftës – tregojnë një patriotizëm të madh Jugosllav dhe një bindje absolute ndaj vlerave të Titoizmit. Mendimet e tij ndryshuan, kur si kruehtar i Institutit të Levizjeve të Klases Punëtore në Zagreb, filloi të studjonte me thellë Luftën e Dytë Botërore. Ai zbuloi se pamja që kishte ai për atë kohë, e pranuar gjerësisht edhe nga të tjerët, nuk ishte e njëjtë me atë që zbuloi nga studimet.

Pjesa më e madhe e shkrimeve revizioniste të Tudjman ishin një kontribut i rëndësishëm për një kuptim më të mirë të Luftës së Dytë Botërore. Si gjeneral ai kishte mundësi të shihte dokumente që historianet të tjerë nuk kishin mundësi të studjonin dhe kjo e bëri atë të kuptonte se Kroacisë i ishte bërë një padrejtësi e madhe historike.

Pjesa më e diskutueshme është numri i të vrarëve në luftë, dhe vëcanërisht, numri i të vrarëve nga Ustashtet në kampin e përqendrimit në Jasenovac. Tudjman llogariti se në atë kamp kurrsesi nuk mund të ishin vrarë më tepër se 70,000 njerëz nga të gjitha kombesitë, shifer e cila ishte vetëm një pjesë e vogël e mbi një milion që historianet Serb deklarorin në atë kohë.

Ndërsa më vonë rezultatet e Tudjman pothuajse u pranuan nga të gjithë, Tudjman gjatë 25 vjetëve të ardhshëm filloi të mendonte për një komplot që i ishte bërë vendit të tij.

Kërkimet e Tudjman kishin ndryshuar pikpamjen e tij që kishte pasur kur kishte qene i ri. Si rezultat, gjatë shumë vjetëve të vështirë politik, ai filloi të besonte me shumë zell në teorinë e tij të re.

Më mendjen e tij ai filloi të personifikonte Kroacinë dhe vuajtjet e Kroateve, ndërsa ceshtja e të vrarëve në luftë u shndërrua në një përleshje të vërtetë. Çdo njeri që nuk ishte dakort me gjetjet e tij apo edhe çdo gjë që dukej se nuk ishte në një linjë me përfundimet e tij, për Tudjmanin ishte pjesë e komplotit për të bërë Kroacinë të dukej “një vend i urryer në sytë e botes”.

Ndërsa vitet kalonin dhe Tudjman u bë gjithnjë e më i ashper, pikpamjet e tij u bënë edhe më ekstreme, u

larguan nga studimet e tij fillestare, dhe morren ngjyra anti-Semite. Megjithate, gjate dhjete vjeteve te fundit mendimet e tij kane qene pozicioni zyrtar i Kroacise.

Tudjman le pas vetes nje vend qe hedh poshte faktet e Luftes se Dyte Boterore dhe te kaluares se tij me te fundit, duke ndaluar hetimet e Gjykates per Krimet e Luftes ne Hage dhe duke rrezikuar vendosjen e sanksioneve nderkombetare.

Zgjedhjet paralementare duhet te mbahen perpara 27 Janarit dhe anketimet e opinionit publik tregojne per nje fitore te opozites. Megjithate, vetem kjo nuk do te siguroje nje tranzicion te lehte drejt demokracise sepse Kroacia e sotme eshte e dominuar nga HDZ ne po te njejten menyre qe Partia Komuniste dominonte Jugosllavine dikur.

Korrupsioni dhe nepotizmi jane ne shkalle te gjere, njez me pushtet politik kontrollojne pjesen me te madhe te ekonomise dhe ushtria eshte nje shtet brenda shtetit. Keto interesa te rendesishme nuk mund te tejkalohen pa nje lufte te gjate dhe te ashper.

Ne librin e tij, Impasi i Realiteteve Historike, Tudjman shkruan se: "Njerezit dhe kombet do te sillen ne menyre racionale kur ata kane mbaruar cdo opsion te tyre." Kroacia duket se ka arritur ne kete pike.

Christopher Bennett eshte nje redaktor i vjeter i IWPR dhe nje anetar themelues i Inisiatives se Stabilitetit European, nje organizem me qender ne Berlin qe fokusohet ne gjendjen ne Ballkan.

Location: [Balkans](#)
[Macedonia](#)
[Albania](#)
[Serbia](#)

Source URL: <https://iwpr.net/sq/global-voices/trashegimia-e-tudjman-eshte-nje-peshe-e-rende-ne-qafen-e-kroacise>